

FJALA E DEPUTETIT AGRON GJEKMARKAJ

E ENJTE 15 SHTATOR 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Unë dua të flas për një çështje që na lidh me Europën më shumë se çdo gjë tjetër. Dua të flas për arsimin kombëtar. “Njeriu aq sa di, mundet”. Të vërtetën e kësaj fjale të Bekonit e forcon edhe fakti që ndër disa gjuhë, si në hebraisht, me një fjalë të vetme shprehet ideja me mund dhe ideja me ditë, sepse fuqia shkon mbas dijes. Kësisoj kumtonte një nga mësuesit themelues të shkollave shqipe, Gjergj Fishta, në parlamentin e viteve '20 në një rrekje për t'i bindur kolegët për rëndësinë që kishin shkolla, dija, mësuesi dhe pedagogu në jetën e një kombi. Janë një sërë rrethanash politike, ekonomike dhe sociologjike, prej të cilave arsimit shqiptar, sidomos ai universitar, është goditur në thelbin e ekzistencës së vet, në seriozitet e kredibilitet, dekadë pas dekade, pushtet pas pushteti.

Të shumta kanë qenë ndërhyrjet ligjore, strategjitë, tubimet, premtimet, buja dhe zhurmat, tabelat dhe shifrat, të cilat më së shumti kanë synuar ikjen nga e vërteta. Sot universiteti shqiptar gjendet në një krizë ekzistenciale si në aspektin ekonomik, ashtu edhe në atë akademik. Imazhi i ndryshmit të tij është reduktuar për shumë kohë në shqyerjen e një derë, rrëzimin e një muri, shkuljen e ca pemëve, tkurrjen e një oborri për të bërë mejhane, qoftore, suxhuktore e akçihane me emra kumbues. Ndokush edhe ka bërë para me fondet, me ambientet dhe me projektet, por masa e pedagogëve shqiptarë ka mbetur thellësisht e varfër dhe e dekurajuar.

Pedagogut i mungojnë të ardhurat për të realizuar mbijetesën njerëzore të tij, pse jo edhe për të blerë libra të rinj, për të ndjekur aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Një pedagogu te universitetit të Tiranës i lejohet të aplikojë vetëm një herë në dy vjet për të subvencionuar një konferencë jashtë. Më së shumti mund të paguhet një honorar qesharak dhe

zakonisht nuk mbulohet udhëtimi dhe strehimi me indeksat reale të vendit ku do të shkojë. Artikujt me scopus nuk subvencionohen. Të gjendur në këtë situatë, mbijetesa i shtyn disa prej tyre të bëjnë punë dytësore e terciare dhe kjo energji e kohë rëndon mbi profesionin dhe mbi dijen.

Ne shpesh flasim për konceptin e elitave në një shoqëri, por jemi hipokritë, sepse e përdorim atë fjalë si çamçakëz për të larguar duhmën e erës së keqe nga goja, pasojë e një stomaku që nuk bluan mirë, ose tërheq më shumë se kapaciteti. Zor të jetë kush më afër këtij koncepti të elitarizmit sesa profesorati ynë. Nga njohja ime modeste e politikës shqiptare them se asaj nuk i intereson që kjo trupë intelektuale të jetë e fortë, e pavarur ekonomikisht dhe e zëshme, por duhet të jetë nën presion dhe nën diktat. Relativizimi i mësimdhënësit, i pedagogut, i hap rrugën të fortit, matrahulit, atij që padijen e ka imunitet, aleat, mburojë dhe pafytyrësi. Madje, ndodh që për imazh reformimi dikush nga kjo fashë shoqërore rekrutohet në politikë, u ndodh si inxhinierëve të diplomuar në Europë në një fabrikë të viteve '70, të cilëve Enver Hoxha u tha: "Merrni shembull nga usta Qerimi se si bëhet shkenca jonë socialiste e popullore."

Atij, si në vitet '40, në gjyqet komuniste i vihet përballë besniku i liderit, që i nxjerr sytë në emër të bazës, terrenit dhe urtësisë së tabanit përballë dënglave të librit. Kësisoj, profesorati e përbuz politikën dhe, si rrjedhojë, politika në vetvete bëhet më e shëmtuar, më e dëmshme dhe mbetet pa pasqyrë. Në politikën tonë janë përfshirë pedagogë me poste të larta vendimmarrëse, të cilët kanë harruar që kanë qenë të tillë. Ndoca e kanë tradhtuar universitetin dhe kolegët e një kohe, ca të tjerë janë pasuruar nga mexhitet e verdha të ryshfetit dhe fëmijët e tyre nuk ua kanë besuar një shkolle shqiptare, e cila më shumë prodhon kartonë sesa vende pune, por i strehuan në kolegjet e Amerikës, Europës e ku e kanë gjykuar më mirë e më ëmbël.

Ata e shohin universitetin dhe dijen si armiq, sepse u intereson dekulturimi i shoqërisë, si mundësi më e madhe që propaganda të zërë vend dhe kulti tribal i liderit të duket mbi kodër si mullar. Sot bie në sy me shqetësim shpërfillja e autonomisë universitare në vendimmarrjen qeveritare për çështje që i takojnë arsimit të lartë, vizionit për të, hartimit të ligjeve, akteve ligjore e nënligjore, të cilat, shpesh, bien në kundërshtim me vetë ligjin për arsimin e lartë, po

kaq, edhe me thelbin e autonomisë universitare. Shpërfillja e ekspertizës universitare, gjithashtu, nga ana e shtetit për shërbime të natyrës studimore e kërkimore, të cilat do të duhej t'i zhvillonin universitetet dhe jo grupe anonime të caktuara nga burokracia shtetërore me procedura aspak transparente, ulërin dhe thërret me piskamë: “Pse, o pushtet, zgjedh dudumin apo pse dija, kanga, historia thirren dokrra kah Shqipnija?!”.

Mungesa e mbështetjes serioze të kërkimit shkencor, si në kërkim, ashtu edhe në pjesëmarrjen në botime dhe në konferenca ndërkombëtare, shfaqet si fytyra e Gynplanit, “Njeriut që qesh” të Viktor Hygosë. Prej shumë motesh kërkimi shkencor nuk kuptohet si angazhimi më i lartë intelektual në dobi të dijes e të shoqërisë, nuk vlerësohet si procesi më intensiv e thellues në zotërimin e njohurive dhe aplikimin krijues të tyre, por shihet me mendjelehtësinë më të madhe nga burokratët vendimmarrës. Ai gjykohet si kohë e lirë e pedagogut, si qejf e trill kalimtar, si pasojë mbetet ose i papaguar, ose i paguar në mënyrën më qesharake të mundshme, për më tepër edhe i taksueshëm me taksën famëkeqe të 23%-it, duke e shndërruar shpërblimin e punës kërkimore shkencore në tallje shkurajuese e depersonalizuese. Shakaxhinjtë e përparimit, kësisoj, ndërtojnë fizionominë e vet publike të patrazuar.

Të nderuar kolegë,

Një pedagogu i duhet, më së shumti, ta paguajë vetë udhëtimin, qëndrimin dhe pjesëmarrjen në një konferencë shkencore dhe të shpenzojë jo me pak se një mijë euro për një konference 3-ditore në një vend të BE-së, shifër, e cila e tejkalon, ku e ku, rrogën mesatare të një pedagogu sot në Shqipëri. Profesorati shqiptar është lënë në mëshirë të fatit, ai është thjesht i varfër, me rroga mujore të paindeksuara as edhe një qindarkë që prej kohës “arkeologjike” të Fatos Nanos. Rroga e tij është shumë afër me atë të një mësuesi të thjeshtë. Çdo kërkesë e universiteteve ka hasur në përbuzjen, ndoshta edhe në urrejtjen patologjike për lirinë e botës universitare si hapësira e fundit e mendimit të lirë në këtë vend.

Pedagogët janë konsideruar si birbo dhe si leshko, të cilët kërkojnë qiçra në hell kur vatani ka maraze. Të varfërosh profesoratin, do të thotë ta flakësh elitën e inteligjencies në luftën e përditshme të mbijetesës dhe të fashisësh çdo potencial njerëzor, kërkimor apo profesional në dobi të individit e të shoqërisë. Kampusi universitar ka mbetur një ëndërr në sirtarët e

premtimeve elektorale. Në përgjithësi regjistrimet kudo në Shqipëri kanë pësuar rënie. Le të bëjmë një krahasim për rrogat neto në universitetet e Kosovës dhe të Shqipërisë. Profesori i rregullt i Kosovës merr 1400 euro në muaj pagë neto, ndërsa një profesor doktor i Tiranës merr 820 euro në muaj neto; profesori i asociuar i Prishtinës merr 1290 euro në muaj, ndërsa profesori i asociuar i Shqipërisë merr vetëm 700 euro; doktori i shkencave i Prishtinës merr 900 euro në muaj, ndërsa në Shqipëri merr 620 euro.

Unë e kam të vështirë të bëj akuza, kur nuk kam mundësinë e plotë t'i vërtetoj ato, por në Shqipëri ka një perceptim për korrupsionin; në shtëpitë e këtij vendi, në tryeza dhe ambiente, në debate darke flitet për të, madje flitet shumë me emra, me shifra, me prona, me offshore dhe me financime, ndoshta vetëm gjysma e tyre janë të vërteta, por jam i sigurt se, nëse gjysma e gjysmës do t'u hiqej nga dora agresorëve të pronës dhe parasë publike në 32 vjet, universiteti shqiptar, studenti dhe pedagogu do të ishin të kuotuar dhe të integruar në BE, dinjitozë në dije dhe punë, duke jetuar në vendin e tyre. Studentët po ikin; një pjesë për të studiuar jashtë dhe nuk kthehen, një pjesë sapo mbarojnë studimet këtu, janë të gatshëm për çdo punë si emigrantë kudo në Europë dhe janë mbyllur shumë degë.

Arsimi kërkon një pakt kombëtar; kërkon kontributin e gjithsecilit në këtë sallë, që rrogat e profesoratit të rriten, por të deputetëve pedagogë shumë më tepër. "Transformimi i shtetasve në qytetarë është një mrekulli që vetëm dija dhe shkolla mund ta kryejnë", sigurisht, nëse kjo na intereson. Pedagogët kanë paralajmëruar grevë! Janë në të drejtën e tyre sublime ta bëjnë atë, sepse, kur arsyeja humbet, para forcës kërkohet forcë që arsyeja të rikthehet. PD-ja, duke u kërkuar falje për çfarë ka bërë keq dhe çfarë nuk e ka bërë hiç, u lyp atyre ndjesë dhe i mbështet pa ndoshta e pa sikur. "Rilindja", që na qeveris, i ka qejf postulatet si nyja të ligjërit publik, që i kanë zënë vend deri diku.

Ndonëse e pakërkuar, po jua ofroj unë një: "Çfarë ka qenë shkolla këto vite, është Shqipëria sot, në çdo gjë të vetën, në vese e virtyte dhe çfarë është shkolla sot, do të jetë Shqipëria nesër". Së fundi, kam një kërkesë për ministren Margariti: pak ditë më parë kam takuar dy artistë, çiftin Shundi. Ata kanë ndërtuar një teatër në shtëpinë e tyre të quajtur "Bujtina e Zonjës", një margaritar i zhanrit, një risi që duhet mbështetur, në mënyrë që të tillë të ketë më shumë në

Tiranë, në Shkodër, në Durrës, në Korçë, e kudo. Nëse duhen ndryshime ligjore, që t'u hiqen taksat apo për subvencionim, qoftë edhe modest nga shteti, mos hezitoni. Ligjet tona nuk na penguan për të shembur kisha e xhami dhe nuk ka arsye të na pengojnë për të ndërtuar teatro, sepse, në fund të fundit, teatri nuk është asgjë tjetër veçse përpjekje e dëshpëruar e njeriut për t'i dhënë një kuptim jetës së tij. Faleminderit!